



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR TË UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Nr 82 Prot.

Vlorë, më 31.12. 2018

VENDIM

Nr. 1 Data 26.12.2018

Për miratimin në parim të projekt vendimit, për shfrytëzim të ujit të rrjedhës së përroit të Gurës, degë e lumit Bënç, Degë e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit "Hydrotec 1" për prodhim të energjisë elektrike, Fshati Bënç, Bashkia Tepelenë, Qarku Gjirokastrë, subjektit "Hydro Tec" sh.p.k., me administrator Z. Elton Mataj.

Në bazë të ligjit Nr.111/2012 datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", ligjit nr 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 111/2012 " Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" të V.K.M 416 datë 13.05.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", , Vendimit Nr. 876, datë 14.12.2016 "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit Nr. 662 datë 21.09.2016 "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta ",Vendimit Nr.5 datë 16.02.2016, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016, Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjensisë së Basenit Ujor"; V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni",

VENDOSI

Miratimin në parim të projekt vendimit, për shfrytëzim të ujit të rrjedhës së përroit të Gurës, degë e lumit Bënç, Degë e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit "Hydrotec 1" për prodhim të energjisë elektrike, Fshati Bënç, Bashkia Tepelenë, Qarku Gjirokastrë, subjektit "Hydro Tec" sh.p.k., me administrator Z. Elton Mataj me këto të dhëna:

Koordinatat KRGJSH: X 497358; Y 4452940; Z 987

Prurja mesatare : 0.340 m3/sek

Prurja e llogaritur: 0.320 m3/sek



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR TË UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Prurja e ekologjike: 0.028 m³/sek

Godina e centralit X 496934 Y 4457500 Y 256

Fuqia e instaluar e hidrocentrali llogaritet të jetë 1940 KW

Për përdorimin e këtij burimi ujor duhen të plotësohen me përpikmëri kushtet e lejes.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËS I A.B.U "VJOSË"

Ilir PROFIKA



KRYETAR I K.B.U "VJOSË"

Flamur MAMAJ

